



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0795

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani-kryetar, duke vendosur sipas ankesës së OE “Izo-H” SH.P.K, kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Molerimi dhe suvatimi ne shkolla” me nr. të prokurimit: "632-25-2734-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna Gjakovë, më 01.10.2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE “Izo-H” SH.P.K me nr. 2025/0795 e datës 19.08.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Molerimi dhe suvatimi ne shkolla” me nr. të prokurimit: "632-25-2734-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna Gjakovë.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - Komuna Gjakovë, për aktivitetin e prokurimit “Molerimi dhe suvatimi ne shkolla” me nr. të prokurimit: "632-25-2734-2-2-1".
3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, Operatorit ekonomik OE “Izo-H” SH.P.K sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Komuna Gjakovënë cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 03.04.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Molerimi dhe suvatimi ne shkolla” me nr. të prokurimit: "632-25-2734-2-2-1", ne vlerën e parashikuar 70,000.00 euro.

Me datën 04.08.2025 Autoriteti Kontraktues ka publikuar njoftimin për dhënie të kontratës.

Me datën 08.08.2025, OE "Izo-H" SH.P.K ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. Vendimi lidhur me kërkesën për rishqyrtim është nxjerrë me datën 12.08.2025 dhe është refuzuar kërkesa .

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 19.08.2025 operatori OE "Izo-H" SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0795 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkritazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 01.09.2025 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

Ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar

Të mbetet në fuqi vendimi i AK-së

Përgjigja e AK-së në kërkesën për rishqyrtim të OE "Izo-H" SH.P.K

Operatori Ekonomik "IZOH SH.P.K., me dt.08.08.2025, ka parashtruar kërkesës për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Molerimi dhe suvatimi në shkolla ", Nr. i prokurimit-632-25-2734-2-2-1, Nr. i brendshëm 632-25-036-221.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 12.08.2025, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë: Pretendimet tuaja, janë të pa bazuara. Autoriteti kontraktues konsideron se ju nuk keni plotësuar kërkesat në FDT-së. Ju keni prezantuar diplomën e inxhinierit të ndërtimtarisë, po në diplomën e të njëjtit shkruan Inxhinjer i ndërtimtarisë e jo Inxhinieri i ndërtimtarisë drejtimi konstruktiv siç është kërkuar në FDT-Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.. Andaj, duke u bazuar ne sqarimet e larte përmendur si dhe duke marr ne konsideratë çmimin e ofruar nga ju kërkesa për rishqyrtim refuzohet si e pabazuar.

Pretendimet e Ankuesit OE "IZO-H" ne ankesën 0795/2025

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës ka bërë shkelje në vlerësim të tenderit, pa baze ligjore dhe faktike AK ka bërë shkelje në vlerësim të tenderit, duke mos vlerësuar ne si operator ekonomik "IZO-H" sh.p.k. AK ka shkelur rregullat e prokurimit publik duke përfshirë parimet e ligjshmërisë, parimin e barazisë dhe mosdiskriminimit, parimin e pavarësisë dhe të paanësisë në vendimmarrje.

1. Ne si operator ekonomik konsiderojmë se AK ka bërë shkelje të dispozitave materiale të LPP-s si vijon: Neni 1, Qëllimi i LPP-s nr.04/L-042 Parimet bazike nga neni 4.4

- Neni 7 parimin 1,2 dhe 4 Barazia ne trajtim/ Jo-diskriminim i LPP-s
- Neni 59 parimi 2, 4 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i tenderëve
- Neni 60, parimi 1 Kriteret për dhënie të kontratës.

PRETENDIMI 1.

Ne si operator ekonomik kemi pranuar njoftimin ku AK - Komuna e Gjakovës ka shpallur fitues operatorin ekonomik Grupi i Operatoreve "Mondi sh.p.k One-Group" me çmimin me te lartin nga gjithë operatorët ekonomik me oferte 65.000,00 euro. Ky operator është me çmimin me te larte nga gjithë operatorët tjerë, duke shkelur kriterin e vendosur nga vet AK: Tenderi i përgjegjshëm me Çmimin më te ulët. Përgjegjësi e AK është ta ruaj dhe menaxhoj sa me mirë buxhetin e komunës e jo te shpërblej operator ekonomik me çmimin me te larte. Diferenca mes operatorit me te lire ne Izo-H sh.p.k ne vlere 33.500 euro dhe operatorit 65.000 euro është: 31.500 euro, pra AK po e dëmton qëllimshëm buxhetin e komunës ne vlerën prej 31500 euro, per te njëjtën pune qe mundet me krye me vlere 100 % me pak dhe ti buxhetoj per nevoja tjera mjetet e mbetura.

Pra, ne jemi operatori i përgjegjshëm me çmimin me te lire, ndërsa AK - Komuna e Gjakovës ne mënyre tendencioze na ka shpallur si te papërgjegjshëm ne mënyrë qe te shpërblej operatorin ekonomik me te shtrenjtin me vlere prej 65.000 euro dhe dëmtuar buxhetin e taksave te qytetareve ne vlere prej 31.500 euro.

Konsiderojme AK -Komuna e Gjakoves ka bere shkelje te rende ligjore dhe themelore per ruajten e buxhetit per ta shperblyer nje operator ekonomik me qmimin me te larte.

PRETENDIMI

Ne si operator ekonomik "IZO-H" sh.p.k kemi pranuar letren e eliminimit B42 me arsyetimin

"Ju nuk keni prezentuar nje inxhinier te diplomuar apo master te ndertimtarise-drejtimi konstruktiv me pese vite pervoje pune pas diplomimit"

Ne kemi paraqitur listën me 14 punëtor dhe në krye të listës gjindet Inxhinieri i Ndërtimtarise Jasmir Morina - konstruktiv, i njëjti është me diplome të noterizuar, CV, referenca dhe kontratë për projektin në fjalë.

Inxhinieri i lartcekur ka përvojë mbi 17 vjeqare, i diplomuar më 2008. Pretendimi i AK - Komuna e Gjakovesi qe ne diplomën e inxhinierit shkruan Inxhinier i Ndertimtarise e jo Inxhinier i Ndertimtarise - drejtimi konstruktiv nuk qendron, sepse ne pjesen e gjuhes angleze,

ceket qarte se drejtimi eshte: konstruktiv. Section: Construction

Gjuha angleze eshte nje prej 3 gjuheve zyrtare ne Kosove dhe ju u desht me marre

Pra ne seksionin e gjuhes shqipe shkruan drejtimi: ndertimtari qe eshte sinonim i fjales konstruktiv. Fjala konstruktiv rrjedh prej gjuhes angleze dhe ne shqip perkthehet ndertimtari.

Fjalet ndërtim e konstruktiv jane sinonime dhe perdoren te dyjat njejt, per me shume kur ka paqartesi gjuha shqipe eshte dominante si gjuha e pare zyrtare ne Republiken e Kosoves.

Nese ka gabime apo paqartesi duhet te kerkohet sqarime sipas nenin 59.2 Neni 59.4: Qdo paqartesi ose kunderthenie qe nuk mund te indentifikohet si nje gabim apo mangesi nuk mund te korrigjohet. AK ne raste te tillla duhet e vazhdoje duke kerkuar sqarime ne baze te nenin 59.4 te LPP-s.

Per me shume ne kemi diplomen e re me vendim te Ministris se Arsimit per kontekstin e kesaj fjale.Pretendimet e AK - Komuna e Gjakoves janë jo-ligjore, jo faktike me tendenca diskriminuese keshtuqe kerkojme vleresim korrekt ose ne do vazhdojme me shkallat tjera te ankesave.

PRETENDIMI 3.

AK -Komuna e Gjakoves na ka dhene te drejt ne kerkesen per rishqyrtim te dates 01.07.2025, me vendimin e dates 09.07.2025, pra kane deklaruar qe aprovohet kerkesa per rishqyrtim dhe lenda kthehet ne rivlersim.

Tani, me ri-vendim AK -Komuna e Gjakoves jep arsyjen e njejte per eliminim, ndersa ankesa u aprovuar si e bazuar.

Kjo doket me shum si “dejavu”, zgjatet procesi dhe ne fund mirret vendimi i njejt me arsyetimin e njejt, duke dale ne kundershtrim me vetveten. Vendimi eshte kontravers dhe pa baze ligjore.

- Kërkojmë ri-vleresim te tenderit dhe vleresim korrekt sipas ligjit te LPP-S dhe parimeve te korrektesise e jo diskriminimit.

Kërkojme nga OSHP që lenden ta kthej në rivlersim dhe AK -Komuna e Gjakoves te na shpall fitues ne si operator ekonomik “IZO –H” sh.p.k me qmimin me te lire.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 20.08.2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0795/2025, i cili është dorëzuar me datë 01.09.2025.

Lidhur me pretendimet e OE “Izo-H” SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0795 ka vlerësuar si në vijim:

Përgjigjeje ne pretendimin 1: Ekspertja shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron se, ky aktivitet i prokurimit është kthyer në rivlerësim me aprovimin e kërkesës për rishqyrtim nga po i njëjti OE ankues, ku AK ka aprovuar pjesërisht ankesën dhe ka kthyer aktivitetin në rivlerësim. Pretendimi i bazuar.Në rivlerësim i njëjti prap eliminon OE ankues me arsyetimin e njëjtë. Pretendimi i bazuarOE ankues në ofertë ka bashkangjitur inxhinierin e ndërtimtarisë, në të cilën shkruan pjesën majtas që është DEPARTMENT OF CIVIL ENGINEERING CONSTRUCTION SECTION, me të cilën frazë OE ankues pretendon se është e njëjta si drejtim konstruktiv, mirëpo nuk është, për faktin se ajo pjesë ka të bëjë me përkthimin departamenti Ndërtimtarisë, pra si e tillë, bazuar në diplomën e ofruar, dega/drejtimi i bie ndërtimtari dhe jo konstruktiv siç është kërkuar në dosje të tenderit. Pretendimi i OE ankues nuk qëndron.

Kërkesa e Autoritetit Kontraktues në Dosje të Tenderit:

Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka së paku 10 (dhjetë) punëtorë të mjaftueshëm si dhe të ketë staf profesional për kryerjen e projektit a.) një inxhinier i diplomuar apo master i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv me pesë vite përvojë pune pas diplomimit, b.) një inxhinier i diplomuar apo master i arkitekturës me pesë vite përvojë pune pas diplomimit.

Lista e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj profesional të dëshmohet me CV, diplomë dhe kontrata e punës apo në rast të lidhjes së kontratës mbi vepër duhet specifikuar titullin e projektit për të cilin ka lidhë kontratë, si dhe lista e numrit të punëtorëve të angazhuar me të dhënat në vijim emri, mbiemri i e punëtorit, profesioni, dhe pozicioni në kompani.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues aprovohet si pjesërisht e bazuar ndërsa të mbetet në fuqi vendimi i AK.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritore.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve

ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “IZO-H SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlerësuar se pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE “IZO-H” SH.P.K, janë pjesërisht të bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë pjesërisht të bazuara, të paraqitura ndaj vendimit të autoritetit kontraktues, për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimit ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit ekonomik duhet të aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe mbet në fuqi, vendimi i AK-së për shpërblim me kontratë të operatorin ekonomik për aktivitetin e prokurimit “Molerimi dhe suvatimi ne shkolla” me nr. të prokurimit: "632-25-2734-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna Gjakovë.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, i datës, 04.08.2025 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Molerimi dhe suvatimi ne shkolla” me nr. të prokurimit: "632-25-2734-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues, Komuna Gjakovë.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlerësimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0795, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka

zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës.

Paneli shqyrtues bazuar në faktin se ankesa aprovohet si pjesërisht e bazuar OE "IZO-H" SH.P.K i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj nga të lartcekurat, Paneli Shqyrtues në pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA E GJAKOVËS**
- **OE - " IZO - H " SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: